



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr.456/2010

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), në panelin e përbërë nga, Muharrem Shala kryesues, Xhevdet Abazi dhe Nehat Idrizi, anëtarë, duke vendosur përkritazi për ankesën e Koalicionit për Kosovën e Re me seli në Prishtinë, paraqitur kundër subjektit politik Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës (AAK) për shkak të parregullsive gjatë procesit zgjedhor, në seancën e panelit të mbajtur me 13.12.2010, mori këtë:

VENDIM

REFUZOHET si e pabazuar ankesa e Koalicionit për Kosovën e Re

ARSYETIMI

Më datën 12.12.2010 PZAP-i ka pranuar një ankesë nga Koalicioni për Kosovën e Re në të cilën theksohet se në shkollat “Yll Morina” dhe “Mazllum Pushka” në Gjakovë janë vendosur posterat e AAK-se dhe është rumbullakuar nr 43 dhe 1.

Ne mbështetje të pretendimeve, parashtruesi i ankesës nuk ka bashkangjitur asnjë provë.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, specifikon:

118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmbushin standardet.

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3.6, pika (c) parashohin si vijon:

3.6 (c) *Hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.*

PZAP pasi shqyrtoj dhe analizoi të gjitha shkresat e lendes gjeti se:

-ankesa është e pabazuar

PZAP-i konstaton se ankesa është e parregullt për faktin se nuk i përmban elementet e detyrueshme të parashikuara në nenin 118 paragrafi 1 të LZP-së dhe elementet e parashikuara në nenin 3.6 pika c) të Rregullave dhe Procedurave të PZAP-it, për shkakun se parashtruesi i ankesës nuk i ka bashkangjitur ankesës asnjë dëshmi. Për këto arsye dhe bazuar në dispozitën e nenit 115.1 të LZP, u vendos si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelime, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoha e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

A nr. 456/2010 më datën 13.12.2010

Kryesuesi i Panelit

Muharrem Shala

